



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.153/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Valdete Daka dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit M. U., me vendbanim në rrugën ..., në P., për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 186 par.3, nënpar.3.2 lidhur me par.2, nënpar.2.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur nga mbrojtësit e të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.624/2023 të datës 27.07.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1331/2023 të datës 26.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26 mars 2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës të mbrojtësve të të dënuarit M. U. për mbrojtje të ligjshmërisë, anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1331/2023 i datës 26.01.2024 dhe çështja i kthehet kësaj gjykate në rivendosje.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.624/2023 të datës 27.07.2023, të dënuarit: **M. U.**, e ka gjykuar, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 186 par.3, nënpar.3.2 lidhur me par.2, nënpar.2.5 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej ... (...) viti, në të cilin dënim ia ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës ... deri më datë..., dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, **F. M.**, e ka gjykuar, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 367 par.2, të KPRK-së, i ka shqiptuar

dënim me burgim në kohëzgjatje prej ... (...) muaj, i cili dënim për pjesën e mbetur e me pëlqimin e të dënuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, kurse për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej... (...) euro, ku në kuptim të nenit 76 e 79 të KPRK-së, i shqipton dënim unik me gjobë në shumën prej ... (...) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ...e deri më datë ... (...ditë), pjesa tjetër e dënimit të mbetur me gjobë në shumën prej... (...) euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që ...(...) të gjobës do ti llogaritet 1 (një) ditë burgim. Të dënuarin **A. B.**, e ka gjykuar, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185 par.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej (...) muaj, i cili dënim për pjesën e mbetur e me pëlqimin e të dënuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ...(...) euro, ku në kuptim të nenit 76 e 79 të KPRK-së, i shqipton dënim unik me gjobë në shumën prej ... (...) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ...e deri më datë ...(...) ditë, pjesa tjetër e dënimit të mbetur me gjobë në shumën prej (...) euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzet) të gjobës do ti llogaritet 1 (një) ditë burgim. Të dënuarin **A. B.**, e ka gjykuar, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ...(...) euro, kurse për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, ku në kuptim të nenit 76 e 79 të KPRK-së, i shqipton dënim unik me gjobë në shumën prej ... (...) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ...e deri më datë ...(...) ditë, pjesa tjetër e dënimit të mbetur me gjobë në shumën prej ... (...) euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzet) të gjobës do ti llogaritet 1 (një) ditë burgim. Të dënuarin **J. B.**, e ka gjykuar, për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ...e deri më datë ...(...) ditë, pjesa tjetër e dënimit të mbetur me gjobë në shumën prej ... (...) euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzet) të gjobës do ti llogaritet 1 (një) ditë burgim. Të dënuarin **S. M.**, e ka gjykuar, për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ...e deri më datë ...(...) ditë, pjesa tjetër e dënimit të mbetur me gjobë në shumën prej ... (...) euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzet) të gjobës do ti llogaritet 1 (një)

ditë burgim. Të dënuarin **L. M.**, e ka gjykuar, për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej... (...) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ...e deri më datë (... ditë), pjesa tjetër e dënimit të mbetur me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzet) të gjobës do ti llogaritet 1 (një) ditë burgim. Të dënuarin **A. M.**, e ka gjykuar, për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ...e deri më datë (... ditë), pjesa tjetër e dënimit të mbetur me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzet) të gjobës do ti llogaritet 1 (një) ditë burgim. Të dënuarin **I. B.**, e ka gjykuar, për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ...e deri më datë (... ditë), pjesa tjetër e dënimit të mbetur me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzet) të gjobës do ti llogaritet 1 (një) ditë burgim. Të dënuarin **A. B.**, e ka gjykuar, për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data ...e deri më datë (... ditë), pjesa tjetër e dënimit të mbetur me gjobë në shumën prej ... euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzet) të gjobës do ti llogaritet 1 (një) ditë burgim. Dhe të dënuarin **I. B.**, e ka gjykuar, për veprën penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzet) të gjobës do ti llogaritet 1 (një) ditë burgim. të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga ditësh e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dënuarve në kuptim të nenit 336 par.3 e lidhur me nenin 267 par.2 e 276 par.2, nënpar.2.1 KP-së, u janë konfiskuar këto sende:

1. #1...;
2. # 3 ...
3. # 3...
4. # 5 ...
5. # 5....
6. # 5...
7. # 1...
8. # C...
9. # C...

Të dënuarit janë obliguar që secili veç e veç që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet dhe atë në emër të paushallit gjyqësor

secili nga ... euro, në emër të dy ekspertizave mjeko-ligjore në mënyrë solidare shumë prej ...euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit secili shumë prej ... euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civilo-juridik.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1331/2023 e datës 21.06.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesën e përbashkët të mbrojtësve të të dënuarit M.U., av. A.H. dhe av. M. Ç., ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit M. U., avokati A. H., nga P., për shkak të shkeljeve procedurale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që të aprovohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që të dënuarit t'i shqiptohet dënim më i butë apo lloj tjetër të dënimit (me kusht) ose aktgjykimet të anulohen dhe lënda të kthehet në rivendosje.

- mbrojtësi i të dënuarit M. U., avokatja M. Ç., nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, nga neni 432 lidhur me nenet 384 e 369, shkeljes së ligjit penal ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që të aprovohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe çështja t'ia ktheji në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.88/2024 e datave 11.03.2024 e 13.03.2024, ka propozuar që të aprovohen si të bazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruara nga mbrojtësit e të dënuarit M. U., av. A. H. e av. M. Ç., dhe çështja t'ia kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesa, gjeti se:

- kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara.

Në kërkesat e tyre mbrojtësit e të dënuarve e të cilat janë identike, theksojnë se me rastin e vendosjes lidhur me ankesat e mbrojtësve të pandehurve Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 390 par.1 të KPP-së, sepse nuk i ka njoftuar as të dënuarin e as mbrojtësit e tij për datën dhe kohën e mbajtjes së seancës së kolegjit, ashtu siç ka qenë e detyruar konform dispozitave ligjore, ngase të dënuarit i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, andaj, propozojnë si më lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesat e tyre, pretendimet e mbrojtësve të të dënuarit për mos informim për seancën e shkallës së dytë është i bazuar, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë kundër të cilit është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është marrë pa informimin e të dënuarit dhe mbrojtësve të tij.

Siç rezulton në shkresat e lëndës kolegji penal i gjykatës së shkallës së dytë duke vepruar sipas ankesës së mbrojtësve të të dënuarit nuk i ka njoftuar të njëjtit për datën e seancës dhe me këtë u është pamundësuar që t'i paraqesin pretendimet e tyre në seancën e kolegjit, ashtu që rrjedhimisht, në këtë rast ka pasur shkelje të drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 par.1 dhe 3 pika (c) dhe (d) i KELDNj.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në ekzistimin e kësaj shkelje nuk ka vlerësuar shkeljet tjera të pretenduara meqenëse është evidente që të dënuarit i është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe pjesëmarrja e tij dhe mbrojtësve në seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë e cila kushtëzon anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë duke u bazuar në nenin 384 par.2 nënpar.2.2 të KPP-së.

Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par.1 nënpar.1.2 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.153/2024, më 26 mars 2024

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Agim Maliqi